



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT**  
**BORDI**

Nr. 184 prot  
/2

Tiranë më 04/06 / 2025

**PROCESVERBAL**  
**MBLEDHJE BORDI**

Sot është ditë e martë, data 03.06.2025, ora 12:00.

Të pranishëm nga Bordi: Z.Vasil Tole, Z.Mentor Beqa, Znj.Alma Liço, Znj.Etleva Smaçi, Z.Simon Mirakaj, Z.Niuton Mulleti, Znj.Laureta Roshi.

Rendi i ditës i dakortësuar është si më poshtë:

- I. Shqyrtimi i dokumentacionit dhe procedures per zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv.
- II. Intervistimi i kandidateve per Drejtor Ekzekutiv.
- III. Votimi per zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv.

**Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Bordit Z.Mentor Beqa**

***Hapet Mbledhja***

**M.Beqa:** Mbledhjen e deklaroj të hapur. Jeni njoftuar për rendin e ditës, ku sot kemi për të zgjedhur Drejtorin Ekzekutiv të Institutit. Është bërë verifikimi paraprak nga Njësia Përgjegjëse dhe janë 4 kandidatë të cilët do të intervistojmë sikurse jeni në dijeni. Gjatë kësaj periudhe keni pasur mundësi që gjithsecili prej nesh të njihej me dosjet e kandidatëve.

Para se të fillojmë me intervistimin e kandidatëve nëse keni diçka për të thënë për maledhjen e sotme , dhe munë propozoj që kandidatëve tju lëmë një kohë prej 10 minutash për të paraqitur vizionin e tyre për Institutit. Pas paraqitjes së vizionit nga ana e tyre secili anëtar mund të bëjë pyetje për kandidatin.

*Gjithë anëtarët e pranishëm ishin dakort për kohën që duhet të kishte secili kandidat për të paraqitur vizionin e tij.*

**M.Beqa:** Meqënëse ramë dakort fillojmë me kandidatët. Thërrasim të parën të vetmen kandidatë zonje në konkurrim znj.Ledia Dushi.

*Thirret zonja Ledia Dushi në ambientin ku zhvillohet mbledhja, Kryetari i Bordit e njofton se ka 10 minuta kohë npër të prezantuar vizionin e saj për Institutitin.*

**Ledia Dushi:** Përshëndetje! Jam Ledia Dushi, 47 vjeçë. Aktualisht jam Përgjegjëse e Bibliotekës Marin Barleti në qytetin e Shkodres. Fusha e interesit tim ka filluar me poezinë, pra si poete. Kam një eksperiencë 25 vjeçare edhe si tudiuese ne keto fusha. Ekam parë të arsyeshëm konkurimin jo në aspektin drejtues por në për të dhënë një alternativë në ISKK. Unë studimet I kam në letërsi dhe folklore por e ndiej veten të mundëshme për të drejtuar një institucion që ka në fokus periudhën e komunizmit. Ajo qq më ka bërë përshtypje nga studimet e Institutit eshtë fokusi në një grupim të caktuar por fokusi duhet të jetë më i gjërë. Studimet do ti fokusojat e pasojat e njeriut të krijuar në komunizëm. Mendoj se ajo çfarë eshtë njeriu sot eshtë pasojë e atyre viteve. Do ti zgjeroja studimet edhe në shumë fusha të tjera.

Mendoj se do të ishte e vlefshme puna në terren e studiuesve sot. Shof që numri i personave që kanë jetuar ato vite pas disa kohësh ata nuk do të janë më, ndaj duhet që studiuesit të janë në terren për këta njerëz.

**M.Beqa:** Faleminderit për prezantimin. Vazhdojmë me pyetjet nga anëtarët..

**S.Mirakaj:** A e keni idenë se komunizmi në qytetin e Shkodrës ka dënuar mendimin apo veprimin?

**Ledia Dushi:** Komunizmi në ato vite ka dënuar mendimin.

**A.Liço:** Gjatë prezantimit tuaj thatë se ju do të përballeshit me nostaligjikët e atij sitemi. Mund të më thuash cila do të jetë rruga për këtë përballje ?

**Ledia Dushi:** Narrativa që ka ndjekur Instituti duket sikur janë pozicionuar kundër diçkaje,. Grupet nostalgjike amplifikojnë kujtesën e atyre viteve. Unë mendoj se problem muk eshtë ai grupim por mënyra si pozicionohen drejtuesit e Institutacionit.

**E.Smaçi:** Futja e fushave të reja të studimit ishte me shumë interes te platforma tuaj.

**Ledia Dushi:** Zgjerimi i fushave ka të bëjë me formimin tim që nga fëmijria për ti parë gjérat përtej palëve.

**M.Beqa:** Ka pyetje të tjera? Pytje ska. Shumë faleminderit për prezencën tuaj dhe prezantimin që bëtë.

**Ledia Dushi:** Faleminderit juve.

**M.Beqa:** Vazhdojmë me kandidatët e tjera sipas rendit alfabetik.

*Thirret z, Agim Baçi në ambientin ku zhvillohet mbledhja, Kryetari I Bordit e njofton se ka 10 minuta kohë npër të prezantuar vizionin e tij për Institutitin.*

**A.Baçi:** Unë pata mundësinë të jem pjesë e ISKK për një vit. Mendoj se ka nevoje për diçka që ta kthejë Institutin në një Institutjon që ti imponohet shoqërisë për atë që ka nevojë shoqëria të dijë për kohën e totalitarizmit. Për këtë duhet të dalë në pah natyra totalitare e regjimit dhe për këtë duhen studime komplekse , antropologjike.Instituti mund të ndikojë në përforcimin e të drejtave tranzitore.

Marrdhënia me Bordin të jetë më e afërt e sidomos propozimet për Kuvendin që juve ju ka zgjedhur., dhe propozimet që mund ti bëhen lidhur me organikën e ISKK.

Mund të bëhen sondazhe lidhur me preceptimin publik por ka pengesa ligjore pasi nuk mund të marren ekspertët më të mirë të kësaj fushe. Bordi duhet të jetë një asistues shumë i afërt për këto çështje.

Duhet të bëhen ndryshime në rregulloren e brendshme. Nuk ka një rregullore për database elektronike. Nuk ka një rregullore të mirfilltë për botimet. Në botime nuk mund të peshojnë më shumë autorët e jashtëm sesa studiuesit e ISKK.

Pjesë e rëndësishme mendoj është propaganda. Duhet ti rikthyer autoriteti këtij institucioni si një institucion që përçon në shoqëri atë që ka nevojë shoqëria të dijë për të shkuarën.

Nje pikë tjetër është se do të kërkojë rikthimin te godina e vjetër ku ka qënë Institut i për ti kthyer autoritetin për të komunikuar me populikun dhe institucionë të tjera. Kjo duhet bërë në bashkëpunim me Bordin dhe duke lobuar në Kuvend.

Në marrdhënia me të tretët Institut ka lidhur marrveshje me universitete por duhen që këto marrveshje të zhvillohen dhe duhet që të ndryshojë ligji dhe këta ekspertë më të mirë janë ekspert tekstesh shkollore të bashkëpunojnë me ISKK dhe puna e tyre të ketë rëndësi në atë nivel jo vetëm në Shqipëri por botimet e tyre të përkthehen dhe anglisht. Edhe revista që boton ISKK do të propozoja të botohej edhe në anglisht.

Duhet parë edhe mënyra e komunikimit, pasi gjithçka që ne bëjmë duhet të funksionojë me një një komunikim të gjithëanshëm duke parë edhe median tradicionale por edhe platformat e reja sociale. Për këtë duhet një rregullore qoftë si ruhet arkiva dixhitale apo edhe si shkon te publiku.

Duhet të hartohet edhe një rregullore për menaxhimin e dokumentave për arkivin e ISKK.

**M.Beqa:** Faleminderit! Kush ka pyetje?

**S.Mirakaj:** Çfarë të ka shtyrë për përfundimtarit Drejtorit Ekzekutiv?

**A.Baçi:** Është ndoshta ai amanet i nënës sime kur une dëgjoja kur isha i vogël, që njerzit i thoshin se femijve të tu nuk do të shkojnë në shkollë sepse ke vellain në Spaç. ISKK nuk e konsideroj si vend pune por si amanet për atë që kam unë brënda vetes dhe për shoqërinë

**E.Smaçi:** Synoni që Iskk të jetë nyje tranzitore me institucionë të tjera. Cilët do të janë mekanizmat përfundimtarit këtë?

**A.Baçi:** Ne do të rritim autoritetin në publik dhe do të lobjjmë më shumë, duke pasur parsysh që pika ime e fortë është komunikimi. Ne duhet të jemi këmbëngulës dhe të bëhem i përfundimtarit këtë.

**E.Smaçi:** Si do do bëhet kjo?

**A.Baçi:** Unë dua ta kaloj këtë gjë. Me shkollat artistike dhe me median.

**L.Roshi:** Në raportet e brendshme të ISKK çfarë do të ndryshonit?

**A.Baçi:** Grupet e punës dhe çdo punonjës duhet të ndihet i rëndësishëm dhe të trajtohet me dinjitet. Aftësia përfundimtarit duhet të jetë primare.

**N.Mulleti:** Cila ka qënë pengesa kryesore në punët e ISKK?

**A.Baçi:** Nuk është bërë lobimi i duhur. Duhet të kemi kordinim dhe bashkëpunim. Marrveshjet duhet të bëhen konkrete. Mjetët e sotme janë të mundshme.

**N.Mulleti:** Cilat struktura do të përforcoje brënda Iskk?

**A.Baçi:** Studimet, aktivitetet dhe komunikimin. Nëse do të më besonit këtë pozicion dua bashkëpunimin tuaj përfundimtarit këtë.

**M.Beqa:** Faleminderit. Vazhdojmë me kandidatin tjetër.

*Thirret z. Çelo Hoxha në ambientin ku zhvillohet mbledhja, Kryetari I Bordit e njofton se ka 10 minuta kohë përfundimtarit këtë prezantuar vizionin e tij përfundimtarit.*

**Ç.Hoxha:** E para është vazhdimsia e cila bazohet në projektet afatgjata. Në këto 5 vite që unë kam drejtuar, Institut ka njobur një përmirsim në aspektim organizativ janë miratuar 4 rregullore. Ka një vlersim nga ana e Kontrollit të Lart të Shtetit që është përmirsuar ana administrative e institucionit.

Marrdhëni me jashtë janë përmirsuar, kemi lidhur afërsisht 10 marrveshje me institucionë homologe të jashtme.

Vitin e kaluar kemi organizuar një koferencë ndërkombe të bashkëpunim me Institutit e Hetimeve për Krimet e Komunizmit të Rumanisë. Gjithashtu një koferencë e ngjashme është planifikur edhe në planin vjetor të këtij viti, por që është më e zgjeruar.

Me Poloninë jemi në kontakte për të lidhur marrveshje me Institutitit homolog.

Ideja ka qënë ngritja e Institutitit në nivel ndërkombe.

Një pikë e rëndësishme është përfshirja në dikutimet për historinë e komunizmit e Institucioneve të tjera. Secili shkruan historinë e vet, por ajo që ka ndodhur është një histori. Ne duhet të iniciojmë një debat kombëtar me Institucion për çështje të caktuara të periudhës së komunizmit. Kthimi i gjetjeve shkencore të Institutit në politika. I kemi dërguar Kuvendit 4 raporte me sugjerime dhe rekomandime për ndryshime ligjore. Gjetjet shkencore mund tjuadërgojmë edhe Ministrisë së Arsimit, Institutit të Historisë apo edhe institacioneve të tjera.

Do ndalesha edhe te aksesi që publiku duhet të ketë të informacioni i Iskk. Kjo arrihet mes rrjeteve sociale, aksesi kur të kemi një arkiv elektronike etj. Por për të arritur këto na duhen ambiente, mjete financiare apo edhe burime njerëzore. Arkivi elektronik nuk do të jetë vetëm me informacionin që ne do të hedhim por edhe pasurimi i këtij arkivi me informacione nga individ të cilët ne kemi publikuar.

Një pikë e rëndësishme janë burimet njerëzore. Unë ju kam kushtuar një rëndësi të veçantë. Në ISKK sot janë 5 ose 6 punonjës me Doktoraturë.

Kërto ishin pikat e mia të cilat I kam paraqitur edhe në dokumentacionin e dorëzuar për aplikim.

**M.Beqa:** ju falenderojmë. Vazhdojmë nëse ka pyetje nga kolegët ?

**S.Mirakaj:** Ju thatë se keni marrveshje me Ministrinë e Arsimit, në kurrikulat e shkollës të paktën si statistikë janë future se sa të burgosur politikë ka pasur, sa të pushkatuar dhe sa të zhdukur në periudhën e diktaturës?

**Ç.Hoxha:** Me mbylljen e fjalorit enciklopedik informacioni do ti përcillet ministrisë dhe gjithë institacioneve të tjera.

**A.Liqo:** Në fjalën tuaj ju përmendët bashkpunimet dhe koferencat ndërkombe. Në këto koferanca ju bëni vetëm shkëmbim eksperiencash apo kjo shkon përtej kësaj?

**Ç.Hoxha:** Temat e koferencave janë të ndryshme. Më shumë janë gjetje historike dhe shkëmbime eksperiencash.

**L.Roshi:** Nëse ju nuk do të zgjidheni si Drejtor, çfarë do ti thonit Drejtorit të ardhshëm që mos linte pa bërë nga puna juaj?

**Ç.Hoxha:** Nuk do të doja të isha në atë pozicion që të jepja këshilla. Por gjithsesi do këshilloja të vazhdonte fryshtë e ligjit.

**N.Mulleti:** Ju përmendët se keni bërë propozime për ndryshime ligjore në Kuvend, a mund ti përblydhni cilat janë këto propozime?

**Ç.Hoxha:** Raporti i parë ka të bëjë me paligjshmërinë e Partisë së Punës. Që kur është krijuar e deri në fund ajo ka qënë e paligjshme. I është kërkuar Kuvendit ndryshimet ligjore përvienien në dispozicion të burimeve të nevojshme për dënimin e kimeve të komunizmit. Gjithashtu kemi kërkuar abrogimin e ligjit të dëshmorve dhe krijim e një ligji të ri ku të përfshijnë edhe gjetjet historike të Institutit.

**N.Mulleti:** Pyetja tjetër është se a ka institucioni një metodë për vlerësimin e performancës së punonjësve dhe nëse po në cilët elemente konsiston ?

**Ç. Hoxha:** Shërbimi civil ka një format bazë për vlerësimin e punonjësve dy herë në vit. Vlerësimi bëhet për veprimtarinë e punonjësit dhe për etikën në vendin e punës.

**M.Beqa:** Faleminderit.

*Thirret z. Edlir Orhani në ambientin ku zhvillohet mbledhja, Kryetari i Bordit e njofton se ka 10 minuta kohë për të prezantuar vizionin e tij për Institutin.*

**E.Orhani:** Janë një mori arsyesh se pse kam kandiduar. Kam një përvojë akademike të gjatë dhe aktualisht punoj te AIDSSH. Mendoj se ISKK është institucioni i duhur për të hedhur bazat midis shkencës, edukimit dhe kërkimit. Unë do të përqëndrohesha te kërkimi, që trë bëhej sa më efikas. Mos merrej vetëm me zbardhje dosjesh, por të merrej edhe me vendosjen e drejtësisë. Bashkëpunimi me Autoritetin e Dosjeve do të ishte shumë efikas. Duhet që qasja të jetë një qasje reale mbi dokumentat që shqyrtohen. Shifra reale e të zhdukurve nuk është akoma e saktë.

Do ti kushtoja shumë rëndësi edukimit, leksioneve të hapura në universitet. Do të bënim marrveshje me institucionet të ndryshme të cilat do ti përshtasim sipas karakterit të institucionit.

Një pikë tjetër është se do ti kushtoja shumë vëmendje klasës së prekur në periudhën e komunizmit. Njerëzit drejtpërdrejt të prekur do sillnin një produktivitet të madh në çdo lloj aktiviteti. Do ti kushtoja rëndësidi hënies së titutjve për këtë klasë. Gjithashtu nuk është kërkuar as ndjesë publike ndaj kësaj klase.

Në drejtimin administrativ

të institucionit do tju kushtoja rëndësi të gjitha strukturave. Do bëja pasurimin e arkivës, do rrësja funksionalitetin e kërkuesve shkencorë, që të janë më efikas e më të motivuar. Edhe pjesa që nuk ju njihen gradat shkencore do ta ngre si problem dhe do kërkoj që këto grada tju njihen.

Do të ngrija një fryshtë bashkëpunimi me të gjitha institucionet, për të arritur produktivitet më të mëdha.

Përvoja akademike, përvoja me Kryqin e Kuq dhee përvoja në AIDSSH mendoj se jam i aftë për drejtimin e institucionit. Në marrdhënet e brendshme mendoj se do të vendos një fryshtë pozitive, pasi mendoj se sa më lartë të jesh aq më kokë ulur duhet të jesh.

**M.Beqa:** Faleminderit ! Nëse anëtarët kanë pyetje vazhdojmë me pyetjet.

**S.Mirakaj:** Ju thatë se te AIDSSH jo të gjithë janë në nivelin e duhur. Ti mendon që të gjithë duhet të kenë tituj shkencorë për të punuar në këtë fushë ?

**E.Orhani:** Unë do tju vija shumë rëndësinë historianve dhe njerëzve të thjeshtë që shkruajnë historitë e tyre, por që janë baza që i shërbjnë kujtesës kolektive.

**S.Mirakaj:** Mendon se nga diktatura vetëm një pjesë e popullit ka vuajtur apo të gjithë?

**E.Orhani:** Unë mendoj se kanë vuajtur të gjithë.

**A. Mirakaj:** Ju folët për bërjen e drejtësisë. Çfarë elemntësh keni parasysh për këtë pikë?

**E. Orhani:** Bërrja e drejtësisë përmes kërkimit shkencor besoj se është gjëja më e mirë. Ne të paktën të demaskojmë atë sistem dhe të vendosim një drejtësi tranzitore. Mendoj se dhe shpërblimet ndaj klasës së prekur kanë qënë të pakta.

**L.Roshi:** Keni ju diçka për këtë që është e debatueshme në Institut, që të jetë më e prekshme dhe e drejtpërdrejt nga publiku ?

**E.Orhani:** Unë e përmenda edhe më parë se nëse i mëshojmë kujtesës historike, ne ruajmë trashgiminë historike.

**M.Beqa:** Faleminderit. Intrevistimi i kandidatëve përfundoj. Vazhdojmë më procedurën.

**V.Tole:** Të jemi proceduralisht në rregull duhet të ngrihet një komision prej 3 vetash. Unë do të propozoja një znj.Etleva, z.Niuton dhe znj Liljana mëqë është sekretarja e Bordit. Ky komision merret me administrimin e procesit të votimit të kandidatëve.


*Të gjithë anëtarët e Bordit ranë dakort me propozimin e z. Vasil.*

*Anëtarët e Bordit aprojuan formatin e fletës së votimit.U printuan 7 fletë votimi dhe u vulosën me vulën e sekretarisë në prezencën e anëtarve të Bordit. Gjithashtu u vendos kutia e votimit e votimit ne një vend të dukshem dhe filloj votimi nga ana e anëtarve.*

*Për gjithë procesin e votimit deri në përfundim të procesit Komisioni mbajti proces verbal.*


*Komisioni ne fund shpalli fituesin kandidatin me më shumë vota.*

**M.Beqa:** Pas shpalljes së fituesit nga ana e komisionit, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Mentor Beqa.** 


**Simon Mirakaj.** 

**Vasil Tole.** 

**Etleva Smaçi.** 

**Loreta Roshi.** 

**Alma Mirakaj.** 

**Niuton Mulleti.** 

**Mbajti Provesverbalin: Liljana Aliko**

